

# Raport mbi zbatimin e ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”

www.idp.al

**LISTA E TË DHËNAVE TË HAPURA IDPC**

1. Vendime/Rekomandime për të drejtën e informimit
2. Raporte/Rekomandime të Transparencës
3. Raportet
4. Materiale Ndërgjegjësimore të shprehura për informimin
5. Vendime/Rekomandime të Komisionit të Kushtetut në lidhje me të drejtën
6. Transfertenca të Komisionit të të Dhënave
7. Materiale Ndërgjegjësimore të Komisionit të të Dhënave Personale
8. Vendime/Parashkrimet dhe konstatimet publike
9. Raporte/Rekomandime dhe Propozime
10. Raporte/Rekomandime të Komisionit

**TË DHËNAT E HAPURA**

Në përputhje me Ligjin 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të dokumenteve ekzistuese referuar fushës së veprimtarisë dhe detyrave për të dhënat e hapura."

#	Titulli   Rubrikës	Skedari PDF	Skedari Excel
1	Tabela mbi Vendimmarrjet E Këshillit To Lartë Gjyqësor Dhe Rastet E Konfliktit Te Interesit	TABELA E VENDIMMARRJEVE DHE KONFLIKTIT INTERESAVE.TEJTOR 2024 DHJETOR 2025 PDE	TABELA E VENDIMMARRJEVE DHE KONFLIKTIT INTERF 2024 EX'

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
OPEN DATA**

**LISTA E TË DHËNAVE TË HAPURA PËR KRYEMINISTRINË**

- Udhërrëfyes, Raporte mbi Negociatat dhe Integrimin Europian

1. Udhërrëfyesi "Për miratimin e Udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës",
2. Udhërrëfyesi PAR
3. Udhërrëfyesi "Për miratimin e Udhërrëfyesi për funksionimin e "Institucioneve Demokratike"

Qëndrimi i Përbashkët i Bashkimit Europian për Grup kapitullin "Themetore"  
Raporti "Screening"  
Raport mbi Negociatat dhe Integrimin Europian, Trem 2, 2024

## Përmbajtja

Hyrje .....	2
1. Qëllimi dhe metodologjia e vlerësimit .....	3
2. Gjetjet kryesore.....	4
2.1 Shtrirja institucionale e raportimit.....	4
2.2 Statusi i zbatimit të detyrimeve ligjore .....	4
2.3 Praktikat e publikimit dhe ripërdorimit.....	4
2.4 Njohja e përdoruesve me të drejtën për ripërdorim .....	4
2.5 Frekuenca e përditësimit të të dhënave .....	5
2.6 Kapacitetet institucionale .....	5
2.7 Sfidat kryesore në zbatim.....	5
3. Përfundime.....	6

## Hyrje

Sasia dhe përpunimi i të dhënave, përfshirë edhe të dhënat publike është rritur në mënyrë eksponenciale, vitet e fundit. Evoluimi i shpejtë teknologjik, përdorimi i Inteligjencës Artificiale dhe Internetit të gjërave (IoT), mundësojnë krijimin e shërbimeve apo aplikacioneve të reja, të cilat bazohen në mbledhjen, përdorimin dhe kombinimin e të dhënave.

Në këtë kuadër, objektivi i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” (në vijim “*ligji nr. 33/2022*”), i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën (BE) 2019/1024), është shfrytëzimi i plotë i potencialit të informacionit të sektorit publik për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare mbështetur në praktikatat e Bashkimit Evropian.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) është autoriteti i pavaruar, që monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kuadrit rregullator në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 33/2022 në prill të vitit 2023, Zyra e Komisionerit është gjithashtu autoriteti përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve sipas këtij ligji.

Konkretisht, në nenin 19 të ligjit nr. 33/2022, përcaktohet se Zyra e Komisionerit është përgjegjës për garantimin e zbatimit të së drejtës për ripërdorim të dokumenteve, ndërsa organet e sektorit publik kanë detyrimin të bashkëpunojnë me të duke siguruar informacionin e nevojshëm për ushtrimin e këtij funksioni.

Në përmbushje të kësaj kompetence, Zyra e Komisionerit hartoi dhe shpërndau "Pyetësoin lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", për vlerësimin e nivelit të zbatimit të legjisllacionit mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik i cili iu adresua të gjitha organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, me qëllim mbledhjen e informacionit të standardizuar mbi praktikatat institucionale, kapacitetet ekzistuese dhe sfidat e hasura në zbatimin e ligjit.

Pas administrimit të përgjigjeve, të dhënat e mbledhura u sistemuan dhe u përpunuan, duke mundësuar identifikimin e tendencave kryesore dhe evidentimin e mangësive institucionale. Mbi bazën e këtij procesi të analizës së detajuar, Zyra e Komisionerit ka hartuar këtë raport analitik, i cili synon të ofrojë një pasqyrë të plotë të gjendjes aktuale të zbatimit të ligjit, si dhe shërbejë për bazë krahasuese për nivelin e zbatimit të ligjit nr.33/2022 në vitet në vijim.

## 1. Qëllimi dhe metodologjia e vlerësimit


Ky raport synon të paraqesë një vlerësim të gjendjes së zbatimit të ligjit nr. 33/2022 nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, dy vite pas hyrjes në fuqi të tij.

Për realizimin e këtij vlerësimi, gjatë periudhës qershor – shtator 2025, Zyra e Komisionerit hartoi dhe shpërndau një pyetësor standard pranë 312 organeve të sektorit publik (OSP) dhe sipërmarrjeve publike (SP) që disponojnë faqe zyrtare aktive.

Pyetësoni kishte si objektiva kryesore:

- evidentimin e nivelit të zbatimit të detyrimeve ligjore nga ana e organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike;
- vlerësimin e nivelit të ndërgjegjësimit institucional;
- identifikimin e praktikave të publikimit dhe ripërdorimit të të dhënave;
- evidentimin e sfidave dhe nevojave për mbështetje.

Nga administrimi i pyetësorëve rezulton se kanë kthyer përgjigje 240 institucione, duke arritur një shkallë reagimi prej rreth 77%.



### PYETËSOR LIDHUR ME TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT TË SEKTORIT PUBLIK

1. A ka autoriteti juaj një faqe zyrtare të internetit?
  - Po (ju lutem vendosni lidhjen përkatëse/link).
  - Jo
2. A keni një listë të miratuar të të dhënave të hapura që prodhon dhe publikon institucioni juaj referuar legjislacionit tuaj specifik dhe a është ajo e publikuar në faqen tuaj zyrtare? (neni 7 i ligjit 33/2022)
  - Po (ju lutemi tregoni linkun ku është publikuar).
  - Jo
3. A janë të dhënat e hapura të përfshira në këtë listë, të aksesueshme?
  - Po
  - Jo
4. Cila është Platforma apo Rubrika juaj ku mund të aksesohen të dhënat e hapura, publikuar nga ju?
  - Portali juaj zyrtar (specifikoni faqen/rubrikën përkatëse)
  - Portali Kombëtar i të Dhënave të Hapura [opendata.gov.al](http://opendata.gov.al)
  - Tjetër (saktëso)
5. A keni caktuar një person kontakti për të dhënat e hapura në institucionin

Të dhënat e mbledhura shërbejnë si bazë për analizën e këtij raporti dhe do të mundësojnë krahasime ndër vite për monitorimin e progresit në zbatimin e ligjit.

## 2. Gjetjet kryesore

### 2.1 Shtrirja institucionale e raportimit

Institucionet që kanë kthyer përgjigje përfaqësojnë një gamë të gjerë kategorish të sektorit publik, duke përfshirë institucione qendrore, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe struktura të sistemit të drejtësisë.

Ky nivel i lartë pjesëmarrjeje reflekton një rritje të ndërgjegjësimit institucional dhe një bashkëpunim pozitiv me Zyrën e Komisionerit.

**Tabela nr. 1** Numri i raportimeve të mbledhura sipas kategorive

Kategoria	Nr.
Institucione qendrore dhe të varësisë	136
Institucione të pavaruara	18
Institucione të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori)	31
Sipërmarrje publike	4
Njësitë e vetëqeverisjes vendore	51

### 2.2 Statusi i zbatimit të detyrimeve ligjore

Nga analiza e të dhënave rezulton se:

- ✚ 177 OSP dhe SP kanë miratuar dhe publikuar listën e të dhënave të hapura;
- ✚ 187 OSP dhe SP kanë krijuar rubrikën “Open Data” në faqet zyrtare;
- ✚ 195 OSP dhe SP kanë caktuar një person kontakti për të dhënat e hapura.

Këto tregues evidencojnë një progres të rëndësishëm në fazën fillestare të zbatimit të ligjit, veçanërisht në krijimin e strukturave organizative dhe mekanizmave të transparencës.

### 2.3 Praktikrat e publikimit dhe ripërdorimit

Të dhënat tregojnë se shumica e institucioneve i publikojnë të dhënat pa tarifa, në përputhje me parimin e aksesit të lirë.

Megjithatë, mbetet i kufizuar përdorimi i licencave standarde dhe publikimi në formate plotësisht të ndërveprueshme, duke evidentuar nevojën për përmirësim të standardeve teknike.

### 2.4 Njohja e përdoruesve me të drejtën për ripërdorim

Pjesa më e madhe e OSP dhe SP, konkretisht 185 prej tyre, raportojnë se informimi i përdoruesve bëhet kryesisht:

- përmes publikimit në faqet zyrtare.

Megjithatë, OSP të tjera raportojnë dhe forma më pak të përdorura si:

- informimi me kërkesë;
- komunikimi përmes aktiviteteve;
- media sociale.

## 2.5 Frekuenca e përditësimit të të dhënave

Nga rezultatet e pyetësorit evidentohet se nuk ekziston një standard i unifikuar për përditësimin e të dhënave. Bazuar në vetëdeklarimet e OSP dhe SP, mënyra më e shpeshtë e përditësimit është përditësimi mujor por gjithashtu raportohen përditësime javore, vjetore si dhe përditësim i parregullte në bazë të disponueshmërisë së të dhënave.

## 2.6 Kapacitetet institucionale

Një zhvillim pozitiv është fakti se mbi 80% e institucioneve kanë caktuar një person përgjegjës për të dhënat e hapura, shpesh i njëjtë me koordinatorin për të drejtën e informimit.

Megjithatë, përgjigjet tregojnë se shumë institucione përballen me:

- mungesë personeli të specializuar;
- kapacitete të kufizuara teknike;
- mungesë burimesh financiare.

## 2.7 Sfidat kryesore në zbatim

Analiza e përgjigjeve evidenton disa sfida kryesore:

- nevojë për trajnim dhe udhëzime praktike;
- kufizime në kapacitetet njerëzore;
- mungesë infrastrukture teknologjike;
- ndërjegjësim ende i pamjaftueshëm për rëndësinë e ripërdorimit të të dhënave.

### 3. Përfundime

Dy vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 33/2022, vihet re një progres i dukshëm në vendosjen e bazave institucionale për zbatimin e tij. Institucionet kanë ndërmarrë hapa fillestare të rëndësishme, veçanërisht në miratimin e listave të të dhënave dhe krijimin e strukturave organizative dhe konkretisht caktimin e personit të kontaktit për të dhënat e hapura. Megjithatë, zbatimi i ligjit, mbetet kryesisht në një fazë fillestare dhe kërkon përforcim të mëtejshëm të kapaciteteve teknike, harmonizimin e standardeve të publikimit dhe konsolidimin e kulturës së të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të tyre.

Nga ana tjetër, për organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, është e domosdoshme të rriten kapacitetet njerëzore dhe teknike, të përmirësohen proceset e menaxhimit të të dhënave. Gjithashtu është e rëndësishme të standardizohen formatet e publikimit dhe licencat e ripërdorimit të të dhënave si dhe të rritet frekuenca e përditësimit të tyre.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka një rol kyç në këtë proces. Nga një anë do të vazhdojë të ofrojë trajnime për organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, duke promovuar standarde më të mira për publikimin e të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e tyre. Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit si autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 33/2022 do të sigurojë ndjekjen e zbatimit korrekt të ligjit.

Në përfundim, në dy vitet e para të zbatimit të ligjit nr. 22/2022, janë shënuar hapat e parë institucional, në publikimin e të dhënave të hapura dhe në lehtësimin e ripërdorimit të informacionit publik. Ky raport dhe të dhënat e raportuara nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike do të shërbejnë si një mjet mbështetës për veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, në zbatim të kompetencave të saj mbikëqyrëse sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke orientuar përforcimin e zbatimit të ligjit, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe ripërdorimit të të dhënave në sektorin publik.